

HISTORI E SHKURTËR E AZERBAJXHANIT

nga antikiteti deri në shekullin e XXI

Kaukazi është një rajon i banuar prej një mozaiku popujsh, ku gjëllinë identitete dhe kultura të ndryshme. Gjeografia e rajonit shërben si strehë e këtyre identiteteve dhe kulturave të larmishme. Malet Kaukaz janë një masiv i madh i shtrirë në kryqëzimin e rrugëve midis Lindjes dhe Perëndimit të Azisë së Vogël, Rusisë dhe Iranit. Kjo pozitë e favorshme gjeografike

ka shërbyer dhe shërben si kryqëzim gjeografiko-ekonomik dhe si shtrat identitetesh dhe kulturash të ndryshme, por në thelb të njëjta, të njohura në botë si kaukaziane. Mes këtyre identiteteve dhe kulturave shquan populli dhe kultura azerbajxhanase, nga më të vjetrat në rajon. Një inkursion i shkurtër në historinë e Azerbajxhanit hedh dritë në mënyrë të pashmangshme



Shpella e lashtë Azikh. Rajoni ekonomik i Karabakut, Azerbajxhan

* Drejtor për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Publikun në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Lindur në 1976. Pedagog, studiues, historian. Magister Artium (M.A) në Diplomaci dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Institutin e Studimeve Evropiane, Tiranë. Autor i disa monografive për historinë moderne si edhe i një numër artikujsh studimorë në histori, antropologji kulturore dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të publikuara brenda dhe jashtë vendit.

Albania e lashtë Kaukaziane e Kishit. Sheki, Azerbajxhan

jo vetëm në historinë e rajonit, por edhe në disa etapa të rëndësishme të qytetërimit dhe historisë botërore. Për të kuptuar lashtësinë e rajonit, mjafton të sjellësh ndërmend se malet Kaukaze konsideroheshin si kufi i botës antike greke, ku Zeusi dërgoi për dënim Prometeun. Origjina e patronimit të Azerbajxhanit lidhet apo Tokës së Zjarrit¹, siç njihet ndryshe në analet historike mendohet se i ka rrënjët në besimin e zoroastrianizmit dikur dominues në Azerbajxhan.

Dëshmia më e hershme e vendbanimeve njerëzore në territorin e Azerbajxhanit daton në epokën e vonë të gurit dhe lidhet me kulturën guruchay të shpellës Azykh. Vendbanimet e hershme përfshinin skithët gjatë shekullit IX para Krishtit. Pas skithëve, medët iraniane dominuan zonën në jug të lumit Aras dhe krijuan një perandori të madhe midis viteve 900 dhe 700 para Krishtit, e cila u integrua në Perandorinë Akamenide rreth viteve 550 para Krishtit. Zona u pushtua nga akamenidët duke çuar në përhapjen e zoroastrianizmit. Disa shekuj më vonë, filozofi gjerman Friedrich Nietzsche do të përdorte simbolin e Zarathustrës dhe zoroastrianizmit për të kumtuar mesazhet e tij në shoqërinë moderne të fundit të shekullit XIX. Popullsia më e hershme në territorin e Azerbajxhanit ishte popullsia e albanëve, të cilët krijuan dhe shtetin e tyre. Zhvillimet e mëvonshme historike lidhen me përfshirjen e territoreve të Azerbajxhanit të sotëm në Perandorinë Sasaniane. Perandoria Sasaniane e ktheu Albaninë kaukaziane në një shtet vasal në vitin 252, ndërsa mbreti Urnayr miratoi zyrtarisht krishterimin si fe shtetërore në shekullin IV.² Pavarësisht sundimit sasanid, Albania mbeti një entitet në rajon deri në shekullin IX, ndërsa ishte plotësisht në varësi të Iranit sasanid dhe ruajti monarkinë. Ndonëse ishte një nga vasalët kryesorë të perandorit sasanian, mbreti Alban kishte vetëm një autoritet në dukje dhe marzbani (gubernatori ushtarak) sasanian përfaqësonte autoritetin më të madh civil, fetar dhe ushtarak. Nga ana tjetër, periudha safavide la gjurmë të çmuara në territoret e sotme të Azerbajxhanit. Kjo dinasti nga rendi fetar sufi safavid do të bashkonte territoret e Iranit dhe Azerbajxhanit të sotëm në një unitet politiko-fetar, do të sfidonte osmanët dhe do ta zhvendoste popullsinë mbizotëruese sunite të Iranit drejt islamit shiit. Origjina e safavidëve gjendej në një tarikat mistik islam të themeluar nga Safi al-Din (rreth viteve 1252-1334). Njëri nga pasardhësit e tij, Shah Abbas Ismaili organizoi një ushtri që bashkoi Persinë, pushtoi Irakun dhe u kthye në një sfidë të madhe për frontin lindor të Perandorisë Osmane. Sundimi i Ismailit, princ vetëm 14 vjeç, kreu i ushtrisë dhe kryetar i një tarikati mysliman Shiit, u kthye në simbol të një periudhe lulëzimi politik, ekonomik dhe kulturor. Sundimi i tij në të njëjtën kohë hodhi bazat për periudhën e artë të Dinastisë Safavide të pasardhësit Shah Abbas i Madh (1588-1629).


Historia e territoreve azerbajxhanase 1804-1918

Historia bashkëkohore e Azerbajxhanit është e shënuar nga luftërat ruso-persiane, Traktati i Gulistanit dhe Traktati i Turkmençait. Nga fundi i shekullit XVIII, Rusia perandorake

Mbetjet e monumentit që i përkasin Albanisë Kaukaziane. Sudaghilan, Mingachevir, Azerbajxhan



Një fragment nga teksti i Traktatit të Gulistanit (1813).



kaloj në një qëndrim gjeopolitik më agresiv ndaj dy fqinjëve dhe rivalëve të saj në jug, përkatësisht Iranit dhe Perandorisë Osmane. Perandoria Ruse në mënyrë aktive u përpoq të fitonte zotërimin e rajonit të Kaukazit, i cili, në pjesën më të madhe, ishte në duart e Iranit. Në vitin 1804, rusët pushtuan dhe plaçkitën qytetin e Ganjës, kryeqytetin e Khanatit azerbajxhanas, duke ndezur Luftën Ruso-Persiane të viteve 1804-1813. Rusët, ushtarakisht superiorë, e përfunduan luftën me një fitore që la gjurmë në ndërtimin e shtetit të mëvonshëm në Kaukaz. Perandoria Ruse e kishte praktikë të zakonshme zhvendosjen e popullsisë jo vetëm në Kaukaz, por dhe në rajone të tjera, si Kazakistan apo Siberia. Pas çdo lufte, mijëra e dhjetëra mijëra njerëz të një etnie ndryshonin vendbanim dhe rrjedhimisht ndryshonin edhe pamjen demografike të një rajoni të caktuar. Brenda suazës së një perandorie, siç ishte ajo ruse, zhvendosje të tilla nuk kishin ndonjë pasojë të rëndësishme politike, ndëretnike dhe ndërjetare, sepse, gjithsesi, grupi etnik apo

popullsia që lëvizte gjendej ende brenda juridiksionit të Perandorisë Ruse. Por problemet nisën të shfaqeshin kur, ashtu si pjesë të tjera të kontinentit evropian, edhe popujt e Kaukazit synuan të krijonin shtetet e tyre kombe dhe për shkak të lëvizjeve të mëparshme të popullsisë, u gjendën me pakica të konsiderueshme brenda shteteve të reja që nuk i përkisnin etnisë në shumicë.³ Perandoria Ruse ishte i vetmi shtet sovran ortodoks në Europë dhe në Azi në këto kohë dhe një pjesë të madhe të politikave të saj i mbështeste tek elementët e krishterë ortodoksë si në Perandorinë Otomane ashtu dhe tani në Kaukaz. Për këtë arsye ajo filloi t’u jepte mbështetje të madhe politike dhe kulturore popujve të krishterë në rajon, duke e forcuar identitetin e tyre etno-kulturor, si dhe të rivendoste në territoret e pushtuara rishtazi popuj të krishterë, duke përfshirë armenë, grekë dhe të tjerë nga perandoritë persiane dhe osmane. Sipas nenit 15 të Traktatit të Turkmençait, të gjithë banorëve iu dha e drejta të lëviznin nga rrethet persiane në rrethet ruse brenda një viti. Pra, ky ishte fillimi i procesit të zhvendosjes së armenëve dhe grekëve në Kaukaz në territorin e Azerbajxhanit të sotëm.⁴

Pas një periudhe një shekullore nën dominimin rus, Azerbajxhani u rilind si shtet i pavarur në maj të vitit 1918.

Fillesat e shtetit modern të Azerbajxhanit në vitin 1918 shënuan një evolucion të rëndësishëm në rajonin e Kaukazit, pasi në maj të atij viti partia kryesore Musavat shpalli pavarësinë si Republika Demokratike e Azerbajxhanit, duke miratuar emrin «Azerbajxhan» për republikën e re. Ky emër, që përpara shpalljes së Republikës Demokratike së Azerbajxhanit, përdorej vetëm për t’iu referuar rajonit veriperëndimor të Iranit bashkëkohor.⁵ Në të vërtetë, pas luftërave ruso-persiane, Azerbajxhani u nda në dy pjesë dhe pjesa më e madhe mbeti në Iran. Republika Demokratike e Azerbajxhanit ishte republika e parë parlamentare moderne në botën islame, madje edhe më herët se shumica e vendeve perëndimore. Ndër arritjet e rëndësishme të Parlamentit ishte shtrirja e së drejtës së votës për gratë, duke e bërë Azerbajxhanin kombin e parë mysliman që u dha grave të drejta të barabarta politike me burrat. Një tjetër arritje e rëndësishme e republikës së re ishte themelimi i Universitetit Shtetëror në Baku, i cili ishte universiteti i parë i tipit modern në Lindjen myslimane.

Formimi i shtetit modern azerbajxhanas.

Ndryshimet e identitetit kolektiv të azerbajxhanasve nga periudha e fundit e sovranitetit rus mbi




Ndërtesa e parë administrative e Republikës Demokratike të Azerbajxhanit. Ganja, Azerbajxhan

Azerbajxhanin historik në atë të republikës (1918-1920) dhe në periudhën kur Azerbajxhani u përfshi në Bashkimin Sovjetik janë trajtuar në mënyrë sipërfaqësore, duke i dhënë rëndësi një faktori social ose një tjetri dhe jo duke i trajtuar si një tërësi faktorësh të rëndësishëm socialë që krijuan sinergjinë e nevojshme për të gdhendur identitetin kulturor e kombëtar azerbajxhanas. Mjafton të përmendim faktin se identitetit fetar të azerbajxhanasve i është dhënë një rëndësi më e madhe duke analizuar detaje të ndryshme kulturore që lidhen me të dhe duke i vendosur Azerbajxhanin dhe azerbajxhanasit në hartat imagjinare të ndarjeve sipas diskursit orientalist. Nga viti 1920-1991, Azerbajxhani u shpall Republikë Socialiste Sovjetike. Kjo periudhë historike ndahet në dy periudha të rëndësishme që transformuan shoqërinë dhe jetën publike në Azerbajxhan. Periudha e parë fillon nga vitet 1920 deri në vdekjen e Stalinit dhe në Kongresin XX të PKBS, më 1956, ndërsa periudha e dytë nga viti 1956 deri në rrëzimin e komunizmit dhe

shpalljen e pavarësisë në vitin 1991. Azerbajxhani dhe shoqëria azerbajxhanase hynë në rrugën e sovjetizimit të shpejtë, ku u shkërmoqën marrëdhëniet e mëparshme ekonomike dhe shoqërore dhe iu nënshtruan eksperimentit të ndërtimit të socializmit. Në regjimin komunist nën Bashkimin Sovjetik u bënë përpjekje që besimet dhe zakonet e rrënosura prej kohësh të shfuqizoheshin në shërbim të "idealit" të njeriut të ri. Inxhinieria sociale e transformimit të Azerbajxhanit në një republikë sovjetike nuk u përqëndruan vetëm në reformat në ekonomi, industri dhe bujqësi por deri dhe ndryshimin e realitetit etnik në terren. Që herët, në nëntor në 1920, rajoni i Zangezuri-it që i përkiste Azerbajxhanit iu dha administrativisht Armenisë për të ndaluar që Turqia të ndabnte kufi të përbashkët me Azerbajxhanin, me synimin që në ardhmen ti jepnin Armenisë, rajonin e Nakhchivan-it.

Nga viti 1930 deri në vitin 1952, qeveria e Bashkimit Sovjetik, me urdhër të Stalinit dhe nën drejtimin e

Vendimi i Këshillit të Ministrave të BRSS për dëbimin e Azerbajxhanasve nga toka e tyre amtare - Azerbajxhani Perëndimor (23.12.1947)



zyrtarit të NKVD, Lavrentiy Beria, transferoi me forcë popullsi të grupeve të ndryshme. Këto veprime mund të klasifikohen si më poshtë: dëbimet e kategorive «antisovjetike» të popullsisë (shpesh të klasifikuara si «armiq të punëtorëve»), dëbimet e kombësive të tëra, transferimi i fuqisë punëtore dhe migrimet e organizuara në drejtime të kundërta për të mbushur etnikisht territoret që duhej të mos kishin kompaktësi etnike ose lidhje etnike me shtete që konsideroheshin kundërshtarë. Gjatë viteve 1948-1953 regjimi komunist stalinist ndërmori deportimin e 150.000 azerbajxhanasve nga Republika Socialiste e Armenisë, me qëllim që të pengonte një lidhje territoriale mes Azerbajxhanit dhe Turqisë, që konsiderohej vend armik i Bashkimit Sovjetik. Të dëbuarit u vendosën në Saatli, Imishli, Goychay, Kurdemir dhe në rajonet e Sabirabadit. Më 18 dhjetor të vitit 1997, Presidenti Hajdar Aliev nënshkroi një dekret që dënonte dëbimin me dhunë të këtyre familjeve nga Armenia.⁶

Stabilitet dhe prosperitet (1991-2023)

Në Azerbajxhan, brezi i porsa dalë nga Lufta e Dytë Botërore, pas vdekjes së Stalinit, pati mundësinë që të qeveriste, por dhe të formësonte identitetin kulturor dhe kombëtar azerbajxhanas. Në vitin 1969, Hajdar Alievi u zgjodh Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë

Komuniste të Azerbajxhanit në seancën plenare të mbajtur më 12 korrik 1969. Hajdar Alievi bëri disa përparime në luftën kundër korrupsionit, duke ndërmarrë disa hapa konkrete, siç ishte ndjekja ligjore e disa zyrtarëve të lartë lokalë apo ndalimi i fëmijëve të nomenklaturës komuniste që të ndiqnin Fakultetin Juridik. Gjatë periudhës së udhëheqjes së Alievit, përpjekjet e tij çuan në rritje të konsiderueshme të treguesve ekonomikë, socialë dhe kulturorë të Republikës Sovjetike të Azerbajxhanit. Alievi u bë ndoshta udhëheqësi republikan më i suksesshëm, duke ngritur profilin e republikës së paprivilegjuar dhe duke promovuar vazhdimisht azerbajxhanasit në poste të larta, duke mundësuar në këtë mënyrë krijimin e elitës administrative azerbajxhanase, e cila në vitet '90 do të mernte përsipër udhëheqjen e vendit. Një seri ngjarjesh të rënies së komunizmit në Evropën Lindore dhe Bashkimin Sovjetik përshpejtuan ndryshimet demokratike në Azerbajxhan dhe themelimin e shtetit modern të pavarur azerbajxhanas. Tensionet etnike rreth Karabakut midis armenëve dhe azerbajxhanasve përshpejtuan procesin e shpalljes së pavarësisë të Azerbajxhanit ndaj Bashkimit Sovjetik. Në vitin 1990, Këshilli Suprem i Republikës Socialiste Sovjetike të Azerbajxhanit hoqi fjalët «socialiste sovjetike» nga titulli, miratoi «Deklaratën e Sovranitetit të Republikës së Azerbajxhanit» dhe rivendosi flamurin e Republikës Demokratike të Azerbajxhanit si flamur shtetëror. Si pasojë e përpjekjes së dështuar të grushtit të shtetit sovjetik të vitit 1991 në Moskë, Këshilli i Lartë i Azerbajxhanit miratoi Deklaratën e Pavarësisë më 18 tetor 1991, e cila u afirmua nga një referendum mbarëkombëtar në dhjetor 1991. Me shpalljen e pavarësisë nga Bashkimi Sovjetik në vitin 1991, Azerbajxhani mori një rëndësi të madhe në skenën ndërkombëtare, duke e bërë rajonin veçanërisht të rëndësishëm. Tashmë Kaukazi nuk ishte më një pjesë e Bashkimit Sovjetik, i njohur më së shumti për gjeografinë malore dhe të pakalueshme. Me shpalljen e pavarësisë së shteteve të ndryshme të rajonit, Kaukazi dhe veçanërisht Azerbajxhani u shndërruan në një prej pikave kyçe të energjisë në botë. Ky zhvillim e ndryshoi krejtësisht gjeografinë e Kaukazit.⁷ Viti 1994 shënoi kthesë për stabilitet dhe krijimin e mundësive për zhvillimin ekonomik të Azerbajxhanit. Presidenti Heydar Aliyev, pas dy përpjekjeve të dështuara që iu bënë për atentat, përforcoi më tepër elementet e sigurisë brenda vendit dhe ndërmori një sërë hapash në politikën e jashtme, që siguruan paqen dhe stabilitetin në rajon. Gjatë administratës së Aliyevit, politika e jashtme e Azerbajxhanit u ribalancua. Marrëdhëniet dypalëshe midis Azerbajxhanit dhe vendeve të tjera, si dhe

Ceremonia e nënshkrimit të "Kontratës së Shekullit" (20.09.1994)

bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare u thelluan. Një vend të veçantë zuri marrëdhëniet diplomatike me OKB-në, si organizmi më i lartë diplomatik botëror ku mund të adresohet zgjidhja e çështjes së Karabakut. Presidenti Aliyev e miratoi Dokumentin e Prezantimit të Partneritetit për Paqe më 19 prill 1996. Një vit e gjysmë më vonë, në nëntor 1997, Republika e Azerbajxhanit iu bashkua Procesit të Planifikimit dhe Rishikimit të Partneritetit për Paqe. Asambleja Parlamentare e NATO-s gjithashtu e bëri Azerbajxhanin një anëtar të asociuar të saj në nëntor 1997. Partneri tjetër kryesor perëndimor i politikës së jashtme të Azerbajxhanit përgjatë kësaj kohe ishte Bashkimi Europian. Marrëveshja e Partneritetit dhe Bashkëpunimit ndërmjet Bashkimit Europian dhe Republikës së Azerbajxhanit u nënshkrua në Luksemburg më 22 prill 1996 dhe hyri në fuqi më 22 qershor 1999. Ajo premtonte bashkëpunim në fushat e tregtisë, investimeve, ekonomisë, legjislationit, kulturës, imigracionit dhe parandalimin e tregtisë së paligjshme. Azerbajxhani përfitoi ndihmë nga BE-ja për reformat ekonomike në vend nëpërmjet programeve TACIS dhe TRACECA.

Presidenca e Heydar Aliyevit (1993-2003) pasqyroi ndryshimet e mëdha politike, sociale dhe ekonomike që ndodhën në Kaukaz pas rënies së Bashkimit Sovjetik, rilindjes së shteteve të reja kombëtare, rritjes së nacionalizmit dhe konflikteve etnike, shpërbërjes së ekonomisë së planifikuar, krizës ekonomike e demografike, themelimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, ringritjes ekonomike dhe përfaqësimit në politikën botërore të Republikës së Azerbajxhanit me dinjitet e barazi me vendet e rajonit. Presidenti Heydar Aliyev ka merita të veçanta për rivendosjen e stabilitetit në Azerbajxhan dhe kthimin e vendit në një prodhues të madh ndërkombëtar të energjisë. Në këtë mënyrë u arrit që kriza etnike e Karabakut të mos ndikonte në vektorët politikë të zhvillimit të vendit dhe shfrytëzimi i burimeve të energjisë të bënte të mundur rritjen ekonomike dhe standardin e jetesës në Azerbajxhan. Presidenti Heydar Aliyev vdiq më 12 dhjetor 2003 në klinikën e Clevelandit në ShBA. Atij iu bë një funeral i madh shtetëror dhe u varros në varrezat Alley of Honor në Baku. Sivjet në Azerbajxhan festohet 100 vjetori i lindjes së Presidentit Heydar Aliyev, personalitetit që

Heydar Aliyev



rithemeloj Azerbajxhanin modern. Ky vit është shpallur vit përkujtimor në nder të figurës së tij shtetformuese.

Presidenti i ri Ilham Aliyev ka ndjekur të njëjtat parime si Presidenti Heydar Aliyev në formulimin e politikës së jashtme. Kjo politikë përfshin bashkëpunimin e ngushtë me Bashkimin Europian (BE), lidhje të forta ekonomike me Rusinë, bashkëpunim me NATO-n nëpërmjet Planit të Veprimit të Partneritetit Individual NATO-Azerbajxhan, bashkëpunim të ngushtë me Turqinë dhe marrëdhënie të ngushta me Organizatën e Bashkëpunimit Islamik. Një marrëdhënie e veçantë është ndjekur me OKB-në, si organizata ku është adresuar vazhdimisht zgjidhja e problemit të Karabakut. Bumi ekonomik i viteve 2005-2007, marrëdhëniet diplomatike të ekuilibruara, si dhe vendosmëria për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme diplomatike për rajonin e Karabakut duket se i dhanë mundësi Partisë së Azerbajxhanit të Ri dhe Presidentit Ilham Aliyev të siguronin disa mandate rresht për qeverisjen e vendit në vitet 2008, 2013 dhe 2018. Stabiliteti politik, zhvillimi ekonomik, si dhe këmbëngulja për të gjetur një zgjidhje diplomatike për rajonin e Karabakut, që përbën rreth 20% të territorit të Azerbajxhanit, u përshkallëzuan në ngjarjet e vitit 2020, që janë një pikë kthese për historinë e rajonit dhe të konflikteve etnike. Lufta ishte e pashmangshme, pasi për të ruajtur *status quo*-në në rajon, Azerbajxhani nuk mund të toleronte lënien jashtë administrimit të tij të 1/5 së territorit të vet. Luftimet filluan në mëngjesin e

27 shtatorit 2020 me një ofensivë të Azerbajxhanit përgjatë vijës së kontaktit të vendosur pas luftës së parë të Karabakut (1988–1994), me qëllimin kryesor për të rikuperuar rrethet malore të Karabakut jugor.

Pas marrjes së Shushës, qyteti i dytë më i madh në Karabak, u nënshkrua një marrëveshje armëpushimi midis Presidentit të Azerbajxhanit Ilham Aliyev, Kryeministrit të Armenisë Nikol Pashinyan dhe Presidentit të Rusisë Vladimir Putin, duke u dhënë fund të gjitha konflikteve me armë në zonë nga data 10 nëntor 2020. Sipas marrëveshjes, palët ndërluftuese mbanin kontrollin e zonave brenda Karabakut në kohën e armëpushimit, ndërsa Armenia ia ktheu Azerbajxhanit territoret përreth, që i kishte pushtuar që nga viti 1994. Marrëveshja e arritur nuk është paqe përfundimtare dhe për të arritur një paqe të qëndrueshme po zhvillohen raunde bisedimesh mes Armenisë dhe Azerbajxhanit në Bruksel. Diplomacia azerbajxhanase synon të arrijë nënshkrimin e një traktati paqeje që do përfshijë njohjen e tërësisë territoriale të Azerbajxhanit, sigurimin e rrugëve energjetike dhe në të njëjtën kohë dhënien e garancive për mbrojtjen e të drejtave të popullsisë armene njëlloj si për të gjithë shtetasit e tjerë azerbajxhanas. Tirana zyrtare e ka mbështetur përherë integritetin territorial të Azerbajxhanit dhe zbatimin e rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Zhvillime pozitive në dialogun mes palëve ndodhën gjatë kryesimit shqiptar të



Azerbajxhani ka rivendosur plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial

OSBE-së. (Deklarata tripalëshe e nënshkruar më 10 nëntor 2020 midis Azerbajxhanit, Armenisë dhe Rusisë).⁸

Marrëdhëniet diplomatike midis Shqipërisë dhe Azerbajxhanit janë të shkëlqyera mbështetur në reciprocitetin dhe bashkëpunimin e ngushtë në të gjitha fushat. Mbështetja e pakushtëzuar që Shqipëria i ka dhënë Azerbajxhanit për sigurimin e tërësisë së tij territoriale, por edhe mbështetja e Azerbajxhanit për ta përfshirë Shqipërinë në projektet energjetike ndërkombëtare ka krijuar një klimë shumë të mirë bashkëpunimi politik, ekonomik e kulturor midis botës shqiptare dhe asaj azerbajxhanase. Perspektivat e këtij zhvillimi përforcohen më shumë edhe nga fakti që Azerbajxhani dhe Shqipëria janë tashmë partnerë në projektin TAP, çka do të thotë se të dyja vendet po punojnë për sigurimin e burimeve energjetike, që mbeten sfida të politikës globale. Hapja e ambasadave në kryeqytetet respektive kontribuon tashmë më shumë për ndërtimin e një vije lineare zhvillimi ekonomik e kulturor nga Kaukazet në Ballkan, duke prodhuar në të njëjtën kohë paqe dhe stabilitet në rajonet përkatëse. 🌱

Bibliografia:

1. Etimologjia e këtij emri mendohet se i ka rrënjët në zoroastrianizmin dikur dominues në atë rajon.
2. M. L. Chaumont, "Albania", Encyclopædia Iranica. 1984, f. 806-810.
3. Ledion Krisafi, Gjeopolitika dhe ligji ndërkombëtar në konfliktin Armeni-Azerbajxhan, Kapitulli 3, Shtëpia botuese: Red & Black, 2021.
4. Dorian Koçi. Një histori e shkurtër e Azerbajxhanit. Toena, Tiranë, 2022, f. 43
5. Atabaki Touraj, Azerbaijan: Ethnicity and the Struggle for Power in Iran, I.B.Tauris, 2002, f. 25.
6. Dorian Koçi. Një histori e shkurtër e Azerbajxhanit. Toena, Tiranë, 2022, f.114-115
7. Ledion Krisafi, Gjeopolitika dhe ligji ndërkombëtar në konfliktin Armeni-Azerbajxhan, Kapitulli 3, Shtëpia botuese: Red & Black, 2021.
8. Marrëdhëniet Shqipëri - Azerbajxhan, marrë nga interneti: <https://punetejashtme.gov.al/marredheniet-shqiperi-azerbajxhan/>.
9. Andrew E. Kramer, "Facing Military Debacle, Armenia Accepts a Deal in Nagorno-Karabakh War". The New York Times, 10 November 2020.
10. Atabaki Touraj, Azerbaijan: Ethnicity and the Struggle for Power in Iran, I.B.Tauris, 2002.
11. Dorian Koçi. Një histori e shkurtër e Azerbajxhanit. Toena, Tiranë, 2022.
12. Ledion Krisafi, Gjeopolitika dhe ligji ndërkombëtar në konfliktin Armeni-Azerbajxhan, \, Shtëpia botuese: Red & Black, 2021.
13. M.L.Chaumont, "Albania", Encyclopædia Iranica. 1984